



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 72

Datë 23 maj 2014

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 47/2014 datë 24.4.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar 2651
Udhëzim i MPB nr. 90, datë 2.4.2014	Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së shpalljes, për kërkesën e ndryshimit të emrit/mbiemrit 2652
Udhëzim i MPB nr. 91, datë 2.4.2014	Për rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave të konsideruar të papërshtatshëm dhe të atyre me rëndësi historike, të familjeve të shquara në shkallë kombëtare, apo të mirënjohura në bashkinë/komunën, ku ka vendbanimin personi i interesuar..... 2653
Udhëzim i MZHETS nr. 257, datë 28.4.2014	Për zbatimin e vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” 2653
Kërkesë e MTI nr. 2519, datë 9.5.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan, loti III” 2656
Kërkesë e MTI nr. 1926/5, datë 12.5.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Gramsh-Lozhan (Ura Kodovjat-Moglicë)” 2657

LIGJ
Nr. 47/2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
LIGJIN NR. 9355, DATË 10.3.2005, “PËR
NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pika 1, pas fjalëve “ruajtjen e integritetit” shtohen fjalët “e përfshirjen shoqërore për”.

Neni 2

Në nenin 4, pika 13 ndryshohet si më poshtë:

“13. “Të ardhura të familjes” janë të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes nga çdo lloj burimi, përfshirë dhe ata anëtarë që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin anëtarët e familjes me aftësi të kufizuar, në kuptim të këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 5, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, përfitojnë sipas përcaktimeve të nenit 23, pika 3, të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 9, pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Personat që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuajnë dënimin me heqje lirie.

5. Personat që trajtohen në institucionet e përkujdesjes rezidenciale publike, të financuara nga fondet e Buxhetit të Shtetit, për masën e ndihmës ekonomike apo pagesën për aftësinë e kufizuar.”.

Neni 5

Në nenin 11, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 24 muajsh punësimi. Procedurat në rastet e rikthimit në skemën e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Në nenin 20 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore publikon, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit, listën e plotë të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga:

a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes;

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë.

Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar ndihmë ekonomike paraqiten tek administratori shoqëror në njësinë e qeverisjes vendore.

Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe nivelet minimale dhe maksimale të masës për përfitimin e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 7

Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas fjalëve “Buxhetit të Shtetit” shtohen fjalët “duke përfshirë edhe shpenzimet e shërbimit shëndetësor/mjekësor”.

2. Paragrafi i parë numërohet pika “1” dhe, pas saj, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Përfituesit e shërbimeve shoqërore, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor. Kontributi në fondin e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore për këto kategori paguhet nga Buxheti i Shtetit.”.

Neni 8

Pas nenit 41 shtohet neni 41/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 41/1

Ankimi për përfitimin e ndihmës ekonomike

1. Aplikuesi, për përfitimin e ndihmës ekonomike në zonat pilot, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund t'i paraqesë ankesë me shkrim kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore. Ankesat bëhen brenda 7 ditëve pas marrjes së njoftimit. Organi i njësisë së qeverisjes vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 5 ditëve pas marrjes së ankesës.

2. Aplikuesi, për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi i marrë nga organi i qeverisjes vendore nuk është i drejtë, i paraqet ankesë me shkrim drejtorit të zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Ankesat dorëzohen brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga njësia e qeverisjes vendore.

3. Drejtori i zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesës, njofton me shkrim për vendimin e marrë aplikuesin dhe njësinë e qeverisjes vendore, për përfitimin e ndihmës ekonomike, brenda 10 ditëve pas marrjes së ankesës.”.

Neni 9

Në nenin 42/1, fjalia e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kërkesa për të përfituar ndihmën ekonomike bëhet me shkrim nga kryetari i familjes/individit në nevojë.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 24.4.2014

UDHËZIM

Nr. 90, datë 2.4.2014

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES
SË SHPALLJES, PËR KËRKESËN E NDRYSHIMIT
TË EMRIT/MBIEMRIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Forma dhe përmbajtja e shpalljes për kërkesën e ndryshimit të emrit/mbiemrit, e cila duhet t'u njoftohet nëpërmjet publikimit, personave të interesuar për ndryshimin e emrit/mbiemrit të kërkuar, apo atyre personave që mund të preken nga ndryshimi i kërkuar, të jetë sipas modelit, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Prefekti, pasi kryen verifikimet mbi dosjen dhe çmon se janë përmbushur kërkesat dhe procedurat e ligjit për gjendjen civile, përse i përket ndryshimit të emrit/mbiemrit, për shkak të papërshtatshmërisë, urdhëron afishimin e shpalljes së kërkesës në zyrën e gjendjes civile ku është paraqitur kërkesa dhe ku kërkuar ka vendbanimin, si dhe në dy prej gazetave dhe/ose në Fletoren Zyrtare, për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

3. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefekti i qarkut, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarkut.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PUBLIKIM KËRKESE PËR NDRYSHIMIN EMRI/MBIEMRI

Në shqyrtim të praktikës për ndryshimin e emrit/mbiemrit, për shtetasin _____, të paraqitur në zyrën e gjendjes civile të bashkisë/njësisë (emër, mbiemër) bashkiake/komunës _____, ku shtetasi në fjalë ka vendbanimin e tij, banues në _____, pasi janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, në zbatim të pikës 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, sot më datë ____ . ____ . ____ prefekti i qarkut _____ autorizon publikimin e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit të shtetasit për shkak të papërshtatshmërisë

nga: _____

në: _____

Në zbatim të nenit 57/5 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit apo mbiemrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes.

Shpallur në _____, më datë ____ . ____ . _____

UDHËZIM
Nr. 91, datë 2.4.2014

**PËR RREGULLAT LIDHUR ME
PËRCAKTUESHMËRINË E
EMRAVE/MBIEMRAVE TË KONSIDERUAR TË
PAPËRSHTATSHËM DHE TË ATYRE ME
RËNDËSI HISTORIKE, TË FAMILJEVE TË
SHQUARA NË SHKALLË KOMBËTARE, APO TË
MIRËNJOHURA NË BASHKINË/KOMUNËN, KU
KA VENDBANIMIN PERSONI I INTERESUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 7 të nenit 2 nenit 57/2, të pikave 2 dhe 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile

UDHËZOJ:

1. Me paraqitjen pranë zyrës së gjendjes civile të kërkesës, në të cilën ka vendbanimin personi i interesuar që kërkon të kryejë ndryshimin e emrit/mbiemrit, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kryen këto veprime:

a) Pasi bindet për ligjshmërinë e kësaj kërkesë, përsa i përket arsyetimit të parashikuar nga ligjvënësi, kërkesë e cila duhet të bëhet vetëm për shkaqe papërshtatshmërie, i dërgon brenda 60 ditëve, praktikën përkatëse institucionit të prefektit të qarkut, nën juridiksionin e të cilit ndodhet bashkia/njësia bashkiake/komuna, së bashku me njoftimin përkatës, në të cilin duhet të jetë specifikuar emri/mbiemri i kërkuarit, si dhe të dhënën e re (emër/mbiemër) që kërkon të marrë i interesuari në bazë të kërkesës së tij.

b) Me marrjen e këtij njoftimi, institucioni i prefektit të qarkut nis procedurën me karakter verifikues, në bazë të listës së vënë në dispozicion për emrat e papërshtatshëm dhe të emrave me rëndësi historike, të familjeve të shquara në shkallë kombëtare dhe lokale. Në këtë kuadër, ky institucion mund të ndërmarrë dhe iniciativë të mëtjshme konsultimi, për çdo (emër, mbiemër) që nuk është i përfshirë në listë, në kushtet kur gjykohej prej tij, se mund t’i përkasë njërës prej kategorive të sipërpërmendura. Kjo procedurë mund të vijojë rast pas rasti, me institucionet e posaçme kompetente për rastet e papërshtatshmërisë dhe të emrave me rëndësi historike, të familjeve të shquara në shkallë kombëtare.

2. Pasi të ketë përfunduar ky proces dhe të jenë mbledhur përgjigjet e institucioneve përkatëse, në rastet kur emri/mbiemri i ri nuk bën pjesë në kufizimet e paracaktuara ligjore, për të interesuarin, do të vijohet me fazat e mëtjshme të miratimit. Në rast të kundërt, nëpërmjet zyrës së gjendjes civile, të interesuarit do t’i kërkohej përcaktimi i një emri/mbiemri të ri, për të cilin duhet të ndiqet përsëri e njëjta procedurë, si në pikën 1 të këtij udhëzimi.

3. Ky proces do të vijojë me mbledhjen dhe dokumentimin e herëpashershëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në cilësinë e organit epror të shërbimit të gjendjes civile, i cili do të jetë përgjegjës për përditësimin e listës me emra të papërshtatshëm dhe të emrave të figurave me rëndësi historike, të mirënjohura në shkallë kombëtare dhe lokale. Kjo listë fillimisht do të gjenerohet në bazë të mendimeve respektive të dërguara nga institucionet kompetente, të specializuara, bashkëpunuese në këtë proces, si Qendra e Studimeve Albanologjike, Fakulteti i Histori-Filologjisë, dega Gjuhë-Letërsi dhe dega Histori, si dhe në bazë të përgjigjeve të kthyer nga këto institucione për kërkesat e paraqitura nga prefektët rast pas rasti.

4. Për çdo emër të klasifikuar në kategoritë e sipërpërmendura, institucioni i prefektit të qarkut do të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

5. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefektët e qarqeve, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunat dhe në degët e qarkut.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

UDHËZIM
Nr. 257, datë 28.4.2014

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 54, DATË 5.2.2014
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURËS DHE TË MËNYRËS SË DHËNIES
ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË
TJERA TË PASURISË SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të kapitullit IX të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

UDHËZON:

1. Procedurat e konkurimit për dhënien me qira ose enfiteozë të pronës shtetërore kryhen prej organit që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose enfiteozës, sipas përcaktimeve në kreun I të vendimit.

2. Në zbatim të pikës 2 dhe të pikës 5-b të kreut I të vendimit, dhënia me qira e makinerive e pajisjeve, në të gjitha rastet e lidhjes së kontratave, bëhet nga njësia që ka në administrim objektin e kontratës së qirasë, e cila

përcakton vlerën e qirasë mujore për çdo vit, sipas përcaktimeve në pikën 5 të kreut III “Tarifat dhe vlera dyscheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë” të këtij vendimi.

3. Në zbatim të pikës 5-c të kreut I të vendimit, institucioni që ka në administrim objektet e dhëna me leje shfrytëzimi të pasurive minerare, peshkimit, ujërave etj. dhe asetet që kërkohen me qira në ndihmë të aktivitetit të lejes përkatëse, plotëson dokumentacionin për dhënien me qira të tyre, sipas pikës 1, në kreun II të vendimit të cituar dhe e përcjell në institucionin që monitoron lejen e shfrytëzimit, për të lidhur kontratën e qirasë. Kontrata e qirasë lidhet për periudhë jo më të gjatë se afati i lejes së dhënë. Në kontratën e qirasë nuk përfshihet sipërfaqja e dhënë me leje shfrytëzimi, por sipërfaqet dhe objektet në ndihmë të ushtrimit të veprimtarisë për të cilën është licencuar.

4. Në zbatim të pikës 5-ç të kreut I të vendimit, subjekti paraqet në ministrinë që ushtron përgjegjësinë administrative mbi institucionin, ndërmarrjen apo shoqërinë shtetërore që ka në administrim pasurinë përkatëse, kërkesën për kontratë huapërdorjeje për sipërfaqen e ndërtimit të fabrikave, të konfirmuar në biznesplanin e paraqitur për marrjen e lejes së shfrytëzimit, të shoqëruar me dokumentacionin që do të kërkohet nga ministria përkatëse.

5. Në zbatim të pikës 5-d të kreut I, për dhënien me qira të pasurive shtetërore për institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare apo ish-ndërmarrjet, kontratat lidhen nga institucioni qendror që ushtron përgjegjësinë administrative, me afat jo më shumë se 5 vjet. Dokumentacioni për lidhjen e kontratës së qirasë përgatitet sipas pikës 1 të kreut II të vendimit dhe vlera e detyrimit mujor të qirasë aplikohet referuar tarifave dyscheme të përcaktuara në kreun II të vendimit të cituar.

6. Në zbatim të pikës 5-e të kreut I, shtesat në kontratë të sipërfaqeve funksionale në kufi me objektin e kontratës së qirasë, bëhen me qëllim përmirësimit ose shtimit e veprimtarisë së parashikuar në kontratën e qirasë.

Subjekti qiramarrës, që ka të lidhur një kontratë qiraje për pasuri me sipërfaqe të përgjithshme mbi 500 m², paraqet kërkesë të argumentuar pranë institucionit që ka lidhur kontratën, i cili pasi e shqyrton, i kërkon njësisë që ka në administrim pasurinë, të përgatisë dokumentacionin sipas pikës 1-b, “c” dhe “ç” në kreun II të vendimit dhe t’i përcjellë në institucionin që ka lidhur kontratën për të bërë ndryshimet përkatëse.

7. Në zbatim të pikës 8 të kreut I, për kontratat me afat mbi 1 vit, vlera dyscheme e detyrimit mujor të qirasë do të llogaritet duke aplikuar tarifat e përcaktuara në kreun III të vendimit të cituar.

8. Me termin “truall të lirë”, të shprehur në pikën 2 të kreut I dhe në pikën 1-c të kreut III, do të kuptohen rastet kur sipërfaqja është shesh i lirë (por jo tokë bujqësore) dhe nuk është pjesë funksionale e ndonjë objekti ndërtimor.

9. Në zbatim të pikës 1 të kreut IV “Nxitja e biznesit”, për përfitimin e zbritjes së detyrimit mujor të qirasë, qiramarrësi ose enfiteozmarrësi i paraqet qiradhënësit kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

a) Vërtetim për punësimin mesatar vjetor të realizuar në vitin përkatës, të lëshuar nga institucionet shtetërore përkatëse.

b) Raport i ekspertit kontabël për investimet e realizuara nga qiramarrësi ose enfiteozmarrësi në objektin e marrë me qira dhe të paraqitura në bilancet financiare të asaj shoqërie.

c) Bilancin financiar të shoqërisë qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse për vitin përkatës.

Qiradhënësi emëron ekspertë kontabël të autorizuar, për verifikimin e vlerave të investimeve, që subjekti qiramarrës ka kryer në pasurinë e marrë me qira dhe të pasqyruara në llogaritë financiare të tij, për periudhën nga lidhja e kontratës deri në vitin e fundit ushtrimor. Kur vlera e investimeve është në nivelin e shprehur në vendim, qiradhënësi miraton zbritjen e detyrimit mujor të qirasë.

10. Në zbatim të pikës 5 të kreut II “Procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore, kur pasuria që ofrohet për t’u dhënë me qira është me sipërfaqe mbi 500 m² dhe e përshtatshme për zhvillim të përpunimit aktiv, titullari i institucionit që ka të drejtën e lidhjes së kontratës e shpreh këtë në urdhrin përkatës. Kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë ofertë për projekte të përpunimit aktiv, konkurrimi vazhdon me ofertat e tjera.

11. Në zbatim të pikës 2-b të kreut V, përfitojnë shoqëritë që në konkurrim paraqesin projekte për realizim të përpunimit aktiv (FASON) të shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar në njoftimin e botuar dhe me dokumentacionin shtesë si vijon:

a) Autorizimin për përpunimin aktiv, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

b) Kontrata porositë të lidhura me firma të huaja, për përpunim aktiv të mallrave, me afat jo më pak se një vit.

c) Dokumentacionin se ushtrojnë aktivitetet të përpunimit aktiv mbi 1 vit.

d) Vërtetim për numrin e personave të punësuar në 6 muajt e fundit.

e) Në planbiznesin e paraqitur në konkurrim, të përshkruajnë kontraktorët e huaj me të cilët kanë lidhur kontrata biznesi, qëllimin e vlerat e investimit të ndarë në faza dhe zërat e investimit, të kenë parashikuar investime në teknologji, si dhe të kenë parashikuar nivelin e punësimit mbi 50 vetë.

f) Objekt të veprimtarisë së shoqërisë, në certifikatën e regjistrimit të jetë edhe “përpunimi aktiv”.

Kur shoqëritë konkurruese paraqesin projekte me të cilat synojnë të hyjnë në fushën e regjimit të përpunimit aktiv, dokumentacioni shtesë do të jetë si vijon:

a) Kontrata porositë paraprake me firma të huaja, për përpunim aktiv të mallrave.

b) Në planbiznesin e paraqitur në konkurrim, të përshkruajnë kontraktorët e huaj me të cilët kanë lidhur, kanë kontrata biznesi paraprake dhe afati i hyrjes në fuqi të tyre pas lidhjes së kontratës (jo më shumë se tre muaj), qëllimin e vlerat e investimit të ndarë në faza dhe zërat e investimit, të kenë parashikuar investime në teknologji, si dhe të kenë parashikuar nivelin e punësimit jo më pak se 50 vetë.

c) Objekt të veprimtarisë së shoqërisë, në certifikatën e regjistrimit të jetë edhe “përpunimi aktiv”.

12. Në zbatim të pikës 3 të kreut V, propozimi me ofertë “të pakërkuar” mund të bëhet nga subjekte private, shoqata ose institucione të ndryshme, të cilat kërkojnë të kryejnë investime në vlera mbi 2 milionë euro, për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e sportit, kulturës, turizmit, trashëgimisë kulturore, ose në ngritjen e qendrave sociale me tematikë të përcaktuar sociale për shtresa të veçanta të shoqërisë. Ministria përgjegjëse për ekonominë u kërkon institucioneve shtetërore që ushtrojnë të drejtën e administrimit mbi pasurinë që propozohet të merret me qira, plotësimin e dokumentacionit sipas përcaktimeve në pikën 1 të kreut II të vendimit. Pas plotësimit të dokumentacionit, ministria përgjegjëse për ekonominë i propozon Këshillit të Ministrave dhënien me qira pa konkurrim dhe me tarifën simbolike 1 euro/kontrata të pasurisë shtetërore.

13. Në zbatim të pikës 4 të kreut V, për kontratat me tarifë simbolike 1 euro/kontrata pagesa e garancisë së kontratës bëhet sipas faturës së lëshuar nga qiradhënësi dhe kushtet e kthimit të saj janë pjesë e negociatës së kontratës.

14. Në zbatim të pikës 5 të kreut V, kur kontrata me tarifë 1 euro kthehet në kontratë qiraje, për shkak të mosrealizimit të kushteve të saj prej qiramarrësit, veprimi bëhet me urdhër të titullarit të institucionit që ka lidhur kontratën. Pas kësaj kontrata nuk kthehet më në kontratën fillestare.

15. Në zbatim të pikës 6 të kreut V, ministri përgjegjës për ekonominë kalon në kontrata me tarifën simbolike 1 euro kontrata, të gjitha ato kontrata qiraje të lidhura për pasuri me sipërfaqe mbi 500 m², me subjekte që realizojnë përpunim aktiv (FASON) dhe që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

-Janë të pajisur me autorizimin vjetor për përpunim aktiv, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

-Zotërojnë të paktën një kontratë porositë me firma të huaja, për përpunim aktiv të mallrave, me afat jo më pak se një vit.

- Kanë shlyer detyrimet financiare kundrejt kontratës së qirasë deri në fund të vitit 2013.

- Në objektin e marrë me qira kanë punësuar për vitin 2013 dhe tremujorin e parë të vitit 2014, jo më pak se 50 vetë.

- Kanë shlyer detyrimet tatimore.

- Nuk janë në procese gjyqësore apo penale për shkak të aktivitetit.

16. Në zbatim të pikës 2-a të kapitullit VI-të “Monitorimi i kontratave”, njësitë monitoruese të kontratave të qirasë bëjnë dorëzimin e objektit të qiramarrësit jo më vonë se një muaj nga data e lidhjes së kontratës së qirasë ose enfiteozës. Kur objekti nuk dorëzohet brenda këtij afati, pa shkaqe të arsyeshme, kontrata e qirasë do të zgjidhet dhe njësia administrative që ka propozuar dhënien me qira të saj do të mbajë përgjegjësi administrative.

Për kontrata ekzistuese, që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi nuk kanë filluar aktivitetin si rezultat i mosdorëzimit të objektit tek qiramarrësi, për çdo arsye të mundshme, palëve u lihet një afat prej 30 ditësh për dorëzimin e objektit. Nëse pas këtij afati objekti i kontratës nuk ka kaluar tek qiramarrësi, kontrata zgjidhet.

17. Në zbatim të pikës 2-c të kapitullit VI-të “Monitorimi i kontratave”, njësitë monitoruese të kontratave të qirasë, për monitorimin e realizimit të kushteve të kontratës nga qiramarrësi, kryejnë këto detyra:

- Monitorojnë në vijueshmëri aktivitetin që ushtron subjekti qiramarrësi ose enfiteozmarrës, në objektin e marrë me qira, në respektim të qëllimit të lidhjes së kontratës;

- Ndjekin për çdo muaj, që subjektet qiramarrëse ose enfiteozmarrëse të derdhen në afatin e përcaktuar në kontratë detyrimin mujor të qirasë;

- Bëjnë përlllogaritjen e kamatëvonesave dhe ndjekin derdhen e tyre sipas rregullave financiare;

-Monitorojnë respektimin e kushteve të kontratës për investimet që kryhen në objektin e marrë me qira ose enfiteozë dhe kryerjen e tyre në respektim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;

- Monitorojnë respektimin e kushteve të kontratës për nivelin e punësimit që realizohet nga qiramarrësi në objektin e marrë me qira ose enfiteozë;

- Zgjidhin problemet që lindin gjatë kohës që është në fuqi kontrata, për të cilat është përgjegjëse njësia që ka në administrim objektin;

- Mbajnë përgjegjësi për mënyrën e përdorimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave nga qiratë sipas përcaktimeve në kreun VII “Shpërndarja e të ardhurave”;

- Hartojnë çdo 6 muaj akte verifikimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteozmarrëse për realizimin e kushteve të kontratës dhe një kopje e përcjellin në institucionin që ka firmosur kontratën e qirasë.

18. Në zbatim të kreut VI “Monitorimi i kontratave”, detyrat e monitorimit të përcaktuara në pikat 1,2 dhe 3 të këtij kreu, ushtrohen për të gjitha format e kontratave të lidhura sipas këtij vendimi.

19. Në zbatim të pikës 6 të kreut VI “Monitorimi i kontratave”, genplanet e ndryshuara përgatiten nga njësia që ka në administrim objektet e dhëna me qira dhe ndryshimi i tyre në kontratë bëhet me anekskontratë, pa ndryshuar asnjë nga termat e kontratës, që nuk lidhen me sipërfaqen e marrë me qira.

20. Në zbatim të pikës 1 në kreun VIII “Vlefshmëria e kontratave”, kur ndërmarrja, shoqëria apo institucioni shitet para përfundimit të kontratës, në publikimin për shitje do të njoftohet ekzistenca e kontratave të qirasë ose enfiteozës, ku sipërfaqja e truallit mbi të cilin shtrihet pasuria e marrë me qira (sipërfaqja nën objekt plus sipërfaqen funksionale), është mbi 500 m². Në dosjen përkatëse të shitjes duhet të ketë një kopje të kontratës.

21. Në zbatim të pikës 4 të kreut VIII “Vlefshmëria e kontratave”, për rastet kur subjekti kontraktues ka bashkuar disa kontrata në një të vetme, mbështetur në pikën 6 kreu VI i vendimit, në analogji me afatin e hyrjes në fuqi të kontratës bëhet edhe përllogaritja e kohës së konsumimit të saj, që është data e hyrjes në fuqi të kontratës së parë.

22. Në zbatim të paragrafit të fundit në pikën 4 të kreut VIII “Vlefshmëria e kontratave”, pagesa e ekspertëve të miratuar, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo ekspert, urdhërohet nga titullari i institucionit urdhërues të misionit, pasi miraton raportin e tyre.

23. Udhëzimi nr. 4, datë 14.6.2012 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Arben Ahmetaj

KËRKESË
Nr. 2519, datë 9.5.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan, loti III”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 228, datë 29.9.2012 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e tokës së llojit “arë”, është 14 932 180 (katërmëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

LISTA E PASURIVE QE PREKEN PER EFEKTIN E NDERTIMIT TE AUTOSTRADES TIRANES- ELBASAN (segmenti Dalja e tunelit-Elbasan)

Nr.	Emri - Atesia - Mbiemri	Nr. Pasurise	Z.K	Sip.pergji. m 2	Are			Vlera. totale	Shenime
					Sip.shp.m2	cmimi	vlera		
	Fshati MAMEL Z.K.2583								
1	Isuf Stafa	281	2583	3400	124	388	48112	48112	konfirmuar
2	Skender Stafa	281/2	2583	800	154	388	59752	59752	konfirmuar
3	Skender Stafa	279	2583	1700	318	388	123384	123384	konfirmuar
4	Hysen Skora	278/3	2583	4300	625	388	242500	242500	konfirmuar
5	Hamdi Skora	278/4	2583	8500	2859	388	1109292	1109292	konfirmuar
6	Durim Skora	278	2583	7000	1273	388	493924	493924	konfirmuar
7	Beshir Skora	272	2583	2500	2500	388	970000	970000	konfirmuar
8	Beshir Skora	272/11	2583	2500	842	388	326696	326696	konfirmuar
9	I Pidentifikuar	2073	2583		2177	388	844676	844676	Nuk ka informacion
10	I Pidentifikuar	2074	2583		2180	388	845840	845840	Nuk ka informacion
11	Riza Mallosi	265/1	2583	1000	100	388	38800	38800	konfirmuar
12	Musa Mallosi	265/4	2583	1000	303	388	117564	117564	konfirmuar
13	Sali Mallosi	265	2583	2000	669	388	259572	259572	konfirmuar
14	Sali Mallosi	266/6	2583	1000	483	388	187404	187404	konfirmuar
15	Kalem Drufi	267/1	2583	800	217	388	84196	84196	konfirmuar
16	Shygyri Haka	268	2583	500	50	388	19400	19400	konfirmuar
18	Sulejman Drufi	266	2583	2300	1347	388	522636	522636	konfirmuar
20	I Pidentifikuar	1787	2583		732	388	284016	284016	Nuk ka informacion
21	I Pidentifikuar	1860	2583		655	388	254140	254140	Nuk ka informacion
22	I Pidentifikuar	1937	2583		2022	388	784536	784536	Nuk ka informacion
23	I Pidentifikuar	1929	2583		1765	388	684820	684820	Nuk ka informacion
24	I Pidentifikuar	1981	2583		2555	388	991340	991340	Nuk ka informacion
25	I Pidentifikuar	2022	2583		1515	388	587820	587820	Nuk ka informacion
26	I Pidentifikuar	2009	2583		3615	388	1402620	1402620	Nuk ka informacion
27	I Pidentifikuar	2052	2583		465	388	180420	180420	Nuk ka informacion
28	I Pidentifikuar	2094	2583		788	388	305744	305744	Nuk ka informacion
29	I Pidentifikuar	2085	2583		610	388	236680	236680	Nuk ka informacion
30	I Pidentifikuar	2055	2583		735	388	285180	285180	Nuk ka informacion
31	I Pidentifikuar	2048	2583		700	388	271600	271600	Nuk ka informacion
32	I Pidentifikuar	272/1	2583		1121	388	434948	434948	Nuk ka informacion
33	I Pidentifikuar	2044	2583		18	388	6984	6984	Nuk ka informacion
34	I Pidentifikuar	1902	2583		1748	388	678224	678224	Nuk ka informacion
35	I Pidentifikuar	1968	2583		3220	388	1249360	1249360	Nuk ka informacion
							14932180		

KËRKESË**Nr. 1926/5, datë 12.5.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Gramsh-Lozhan (Ura Kodovjat-Moglicë)”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me kuadrin ligjor.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë

apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e shpronësimit është 4 790 617.89 (katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tetëdhjetë e nëntë) lekë.

Pronarët, për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË PROJEKTEVE TË HUAJA, TË BRENDSHME DHE SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
"GRAMSH-LOZHAN" (URA KODOVJAT-MOGLICË)

Nr	Emri i pronarit	Zona Kadastr.	Numri Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Kultura bujqësore drufrutore (lekë)	Vlera Totale (lekë)	Shënime
Fshati Bulçar, Komuna Kodovjat, Gramsh		ZK 1308								
1	SHTET	1308	109/2	ARË	215	112	24080	0	24080.0	KONFIRMIM ZVRPP
2	QEMAL MAKSUT ZENELI	1308	50/1	ARË	280	112	31360	9800	41160.0	KONFIRMIM ZVRPP
3	HEKUR BAJRAM ZENELI	1308	52/21	ARË	160	112	17920	4140	22060.0	KONFIRMIM ZVRPP
4	SHTET	1308	50/2	ARË	355	112	39760	0	39760.0	KONFIRMIM ZVRPP
5	BAJRAM HEKUR ZENELI	1308	49/1	ARË	300	112	33600	6900	40500.0	KONFIRMIM ZVRPP
6	HEKUR BAJRAM ZENELI	1308	49/2	ARË	280	112	31360	5570	36930.0	KONFIRMIM ZVRPP
7	BAJRAM HEKUR ZENELI	1308	49/3	ARË	250	112	28000	8750	36750.0	KONFIRMIM ZVRPP
8	QEMAL MAKSUT ZENELI	1308	52/17	ARË	228	112	25536	8550	34086.0	KONFIRMIM ZVRPP
9	HASAN NEXHIP ZENELI	1308	50/3	ARË	360	112	40320	9600	49920.0	KONFIRMIM ZVRPP
10	NUREDIN MAKSUT ZENELI	1308	52/16	ARË	176	112	19712	9300	29012.0	KONFIRMIM ZVRPP
11	RABIE LLUKAN ZENELI	1308	52/11	ARË	510	112	57120	20250	77370.0	KONFIRMIM ZVRPP
12	REXHEP JONUZ ZENELI	1308	52/10	ARË	297	112	33264	49000	82264.0	KONFIRMIM ZVRPP
13	JONUS IBRAHIM ZENELI	1308	50/4	ARË	125	112	14000	21000	35000.0	KONFIRMIM ZVRPP
14	NUREDIN MAKSUT ZENELI	1308	92/12	ARË	796	112	89152	34050	123202.0	KONFIRMIM ZVRPP
15	SEFER ISMAIL SEMJA	1308	92/11	ARË	65	112	7280	7800	15080.0	KONFIRMIM ZVRPP
16	FATOS RIZA IBRO	1308	92/10	ARË	793	112	88816	42550	131366.0	KONFIRMIM ZVRPP
17	RIZA RAMO IBRO	1308	92/6	ARË	375	112	42000	15650	57650.0	KONFIRMIM ZVRPP
18	FATOS RIZA IBRO	1308	92/3	ARË	145	112	16240	5075	21315.0	KONFIRMIM ZVRPP
19	ENVER RIZA IBRO	1308	92/2	ARË	215	112	24080	21450	45530.0	KONFIRMIM ZVRPP
20	REXHEP JONUZ ZENELI	1308	58/4	ARË	345	112	38640	15150	53790.0	KONFIRMIM ZVRPP
21	SHTET	1308	58/5	TRUALL	256	173	44288	0	44288.0	KONFIRMIM ZVRPP
22	SEFER ISMAIL SEMJA	1308	118/8	ARË	182	112	20384	6370	26754.0	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Bratilë, Komuna Kodovjat, Gramsh		ZK 1266								
23	XHEVIT ZALO KASMI	1266	127/3	ARË	130	112	14560	4550	19110.0	KONFIRMIM ZVRPP
24	FERIT SHASHO KASMI	1266	127/4	ARË	126	112	14112	4410	18522.0	KONFIRMIM ZVRPP
25	KADRI ALI KORONI	1266	127/5	ARË	80	112	8960	2800	11760.0	KONFIRMIM ZVRPP
26	HAKI MUHARREM KASMI	1266	76/2	ARË	65	112	7280	5400	12680.0	KONFIRMIM ZVRPP
27	ADEM BANO KASMI	1266	77/15	TRUALL	10	173	1730	4000	5730.0	KONFIRMIM ZVRPP
28	SHTET	1266	65	PYLL	365	85	31025	0	31025.0	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Kokël, Komuna Kodovjat, Gramsh		ZK 2197								
29	HALIM MERSIN ZHUPANI	2197	9/1	ARË	604	112	67648	12684	80332.0	KONFIRMIM ZVRPP
30	PELLUMB MERSIN ZHUPANI	2197	9/2	ARË	281	112	31472	5901	37373.0	KONFIRMIM ZVRPP
31	MERSIN HAMID ZHUPANI	2197	9/3	ARË	808	112	90496	16968	107464.0	KONFIRMIM ZVRPP
32	SHTET	2197	9/16	ARË	335	112	37520	0	37520.0	KONFIRMIM ZVRPP
33	PELLUMB MERSIN ZHUPANI	2197	9/4	ARË	190	112	21280	3990	25270.0	KONFIRMIM ZVRPP
34	HALIL MERSIN ZHUPANI	2197	9/5	ARË	165	112	18480	3465	21945.0	KONFIRMIM ZVRPP
35	RAMO RIZA FEJA	2197	9/6	ARË	581	112	65072	6972	72044.0	KONFIRMIM ZVRPP
36	SHTET	2197	12	ARË	67	112	7504	0	7504.0	KONFIRMIM ZVRPP
37	NEKI DERVISH LUMANI	2197	9/7	ARË	360	112	40320	54000	94320.0	KONFIRMIM ZVRPP
38	VLADIMIR FEIM MURATI	2197	37/1	ARË	395	112	44240	4740	48980.0	KONFIRMIM ZVRPP
39	SHKENDI REFAT SHOQPE	2197	37/2	ARË	110	112	12320	10412.5	22732.5	KONFIRMIM ZVRPP
40	HEKURAN MYSLIM TRAGJINI	2197	37/3	ARË	126	112	14112	15285	29397.0	KONFIRMIM ZVRPP
41	MUHAMET BEXHET SHQIPJA	2197	37/4	ARË	120	112	13440	4200	17640.0	KONFIRMIM ZVRPP
42	SKENDER MAKSUT MURATI	2197	37/5	ARË	355	112	39760	7668	47428.0	KONFIRMIM ZVRPP
43	QANI ESTREF FEZOLLI	2197	42/14	ARË	71	112	7952	13300	21252.0	KONFIRMIM ZVRPP
44	MEVLAN KAMBER FUSHA	2197	42/13	ARË	425	112	47600	14875	62475.0	KONFIRMIM ZVRPP
45	RESMI MERSIN BREGU	2197	42/12	ARË	70	112	7840	1512	9352.0	KONFIRMIM ZVRPP
46	KAMBER MYSLYM FUSHA	2197	42/11	ARË	55	112	6160	6187.5	12347.5	KONFIRMIM ZVRPP
47	NEVRUZ KAMBER FUSHA	2197	42/10	ARË	70	112	7840	840	8680.0	KONFIRMIM ZVRPP
48	SHYQYRI HAZIZ SHOQPE	2197	42/9	ARË	75	112	8400	2625	11025.0	KONFIRMIM ZVRPP
49	HEKURAN SEIT SHOQPE	2197	42/1	ARË	370	112	41440	24135	65575.0	KONFIRMIM ZVRPP
50	SHTET	2197	44/7	ARË	816	112	91392	0	91392.0	KONFIRMIM ZVRPP
51	SHYQYRI AZIS SHOQPE	2197	44/8	ARË	1220	112	136640	26352	162992.0	KONFIRMIM ZVRPP
52	HAZIZ HASAN SHOQPE	2197	44/9	ARË	950	112	106400	39450	145850.0	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Moglicë, Komuna Moglicë, Korçë		ZK 2710								
53	SHTET	2710	38/1	ARË	10	115	1150	0	1150.0	KONFIRMIM ZVRPP
54	SHTET	2710	38/2	ARË	33	115	3795	0	3795.0	KONFIRMIM ZVRPP
55	SHTET	2710	38/3	ARË	40	115	4600	0	4600.0	KONFIRMIM ZVRPP
56	SHTET	2710	38/10	ARË	82	115	9430	0	9430.0	KONFIRMIM ZVRPP
57	SHTET	2710	38/11	KULLOTË	260	87	22620	0	22620.0	KONFIRMIM ZVRPP
58	SHTET	2710	54/2	TRUALL	20	115	2300	0	2300.0	KONFIRMIM ZVRPP
59	SHTET	2710	55	ARË	570	115	65550	0	65550.0	KONFIRMIM ZVRPP
60	SHTET	2710	830/6	TRUALL	156	115	17940	0	17940.0	KONFIRMIM ZVRPP
61	SHTET	2710	98	KULLOTË	90	87	7830	0	7830.0	KONFIRMIM ZVRPP
62	SHTET	2710	62	ARË	1580	115	181700	0	181700.0	KONFIRMIM ZVRPP
63	SHTET	2710	831	TRUALL	628	115	72220	0	72220.0	KONFIRMIM ZVRPP
64	SHTET	2710	60	ARË	75	115	8625	0	8625.0	KONFIRMIM ZVRPP
65	SHTET	2710	832	TRUALL	1140	115	131100	0	131100.0	KONFIRMIM ZVRPP
66	SHTET	2710	87	ARË	180	115	20700	0	20700.0	KONFIRMIM ZVRPP
67	SHTET	2710	322	ARË	95	115	10925	0	10925.0	KONFIRMIM ZVRPP

68	CEJNIK ALO BIBA	2710	320/1	ARË	81	115	9315	7200	16515.0	KONFIRMIM ZVRPP
69	SELAMI ESTREF HYSENLLARI	2710	838	ARË	60	115	6900	7425	14325.0	KONFIRMIM ZVRPP
70	EDMOND FILA HYSENLLARI	2710	295/1	ARË	160	115	18400	19800	38200.0	KONFIRMIM ZVRPP
71	SHTET	2710	295/2	ARË	410	115	47150	0	47150.0	KONFIRMIM ZVRPP
72	SHTET	2710	295/3	ARË	360	115	41400	0	41400.0	KONFIRMIM ZVRPP
73	BARJAM BEKTASH BARDHI	2710	295/4	ARË	315	115	36225	37800	74025.0	KONFIRMIM ZVRPP
74	SHTET	2710	295/5	ARË	230	115	26450	0	26450.0	KONFIRMIM ZVRPP
75	SHTET	2710	295/6	ARË	125	115	14375	0	14375.0	KONFIRMIM ZVRPP
76	SHTET	2710	295/7	ARË	55	115	6325	0	6325.0	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Gopesh, Komuna Moglicë, Korçë		ZK 1800								
77	SHTET	1800	90	KULLOTË	920	87	80040	0	80040.0	KONFIRMIM ZVRPP
78	FATIME KULLA	1800	353/5	ARË	40	115	4600	1400	6000.0	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Dobërçan, Komuna Moglicë, Korçë		ZK 1494								
79	SHTET	1494	422/2	ARË	40	115	4600	0	4600.0	KONFIRMIM ZVRPP
80	ISMET ISMAL LATIFI	1494	422/1	ARË	240	115	27600	5040	32640.0	KONFIRMIM ZVRPP
81	SHTET	1494	426/23	ARË	310	115	35650	0	35650.0	KONFIRMIM ZVRPP
82	HETEM HAMIT JONKA	1494	426/24	ARË	215	115	24725	4644	29369.0	KONFIRMIM ZVRPP
83	SULLTANA NESIM JONKA	1494	426/25	ARË	160	115	18400	3360	21760.0	KONFIRMIM ZVRPP
84	MUHAMMEDI MUHAMMEDI LALOLLARI	1494	426/26	ARË	200	115	23000	42000	65000.0	KONFIRMIM ZVRPP
85	AGRON NEZMIR LALOLLARI	1494	38/7	JO INFO	555	115	63825	11655	75480.0	KONFIRMIM ZVRPP
86	MUSTAFA RRAPO JONKA	1494	7/16	ARË	60	115	6900	1260	8160.0	KONFIRMIM ZVRPP
87	SHTET	1494	329	ARË	80	115	9200	0	9200.0	KONFIRMIM ZVRPP
88	SHTET	1494	9/4	KULLOTË	80	87	6960	0	6960.0	KONFIRMIM ZVRPP
89	SHTET	1494	12/4	KULLOTË	440	87	38280	0	38280.0	KONFIRMIM ZVRPP
Fshati Maliq Opar, Komuna Moglicë, Korçë		ZK 2575								
90	SHTET	2575	186/1	ARË	727.5	129.1	93920	0	93920.3	KONFIRMIM ZVRPP
91	RIZA ARSHIN SKENDERI	2575	186/3	ARË	82	129.1	10586	0	10586.2	KONFIRMIM ZVRPP
92	NESHAT TAJAR KORONI	2575	186/6	ARË	210	129.1	27111	0	27111.0	KONFIRMIM ZVRPP
93	NEKIE ALUSH KORONI	2575	186/4	ARË	449.6	129.1	58043	0	58043.4	KONFIRMIM ZVRPP
94	SHTET	2575	186/9	ARË	3728.4	129.1	481336	0	481336.4	KONFIRMIM ZVRPP
95	MYFTAR ALI KOKONA	2575	186/5	ARË	284	129.1	36664	0	36664.4	KONFIRMIM ZVRPP
96	DYLBER SULEJMAN SKENDERI	2575	186/7	ARË	18.4	129.1	2375	0	2375.4	KONFIRMIM ZVRPP
97	MYHAMER ARSHIN SKENDERI	2575	186/11	ARË	276.1	129.1	35645	0	35644.5	KONFIRMIM ZVRPP
98	GURI HAXHI KORONI	2575	186/13	ARË	193.4	129.1	24968	0	24967.9	KONFIRMIM ZVRPP
99	SHTET	2575	186/15	ARË	2492.9	129.1	321833	0	321833.4	KONFIRMIM ZVRPP
100	SHTET	2575	186/20	ARË	295.6	129.1	38161.96	0	38162.0	KONFIRMIM ZVRPP
TOTALI					34955.9	m ²	4,051,356.89	739,261.00	4,790,617.89	LEKË

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006